



FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE POLITIKA KUNDËR SHPËLARJES SË PARAVE

1. Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Politika e FKGK-së është të sigurojë parimet jetike të besimit, besueshmërisë dhe stabilitetit. Rrjedhimisht, FKGK-ja është zotuar të ndalojë shpëlarjen e parave dhe/ose cilindo aktivitet tjetër që mundëson shpëlarjen e parave apo financimin e terrorizmit. FKGK-ja është zotuar të respektojë plotësisht ligjet dhe rregulloret në fuqi për të parandaluar përdorimin e produkteve dhe shërbimeve të tij për shpëlarje të parave dhe aktivitete kriminale. Njëkohësisht, FKGK-ja do të veprojë në pajtim me rekomandimet SHL/LFT, parimet dhe standardet e vendosura nga institucionet ndërkombëtare.

2. Në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 03/L-196 për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit (Ligji SHL/LFT), subjekte të caktuara afariste obligohen të marrin masa për të zvogëluar rrezikun e përfshirjes së tyre në shpëlarjen e parave si dhe financimin e aktiviteteve terroriste, si dhe që të raportojnë transaksionet e dyshimta financiare tek Njësia e Inteligjencës Financiare.

3. FKGK-ja nuk i nënshtrohet dispozitave të Ligjit kundër SHL/LFT. Ai është kryesisht garantues i kredive të kualifikuara nga institucionet e kualifikuara financiare për mikro-ndërmarrje, ndërmarrje të vogla dhe të mesme. Si i tillë, FKGK-ja nuk ofron financim drejtpërdrejt, si dhe nuk ka klientë "tradicionale". Megjithatë, njëkohësisht, Ligji për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (LFGK) në mënyrë specifike i ndalon FKGK-së të garantojë kredi që mund të mbështesin aktivitete të paligjshme. Pra, është shumë me rëndësi që FKGK-ja të mos marrë pjesë, pa qëllim apo ndryshe, në asnjë situatë që mund të përfshijë shpëlarjen e parave apo financimin e terrorizmit. Mënyra më efektive për të siguruar përputhshmërinë me këtë ligj është të vendosë dhe të zbatojë udhëzime të qarta për të gjitha fushat e punës së FKGK-së. I gjithë personeli pra është i obliguar të njoftohet me këtë Politikë dhe të respektojë dispozitat e përshkruara si më poshtë.

4. Shpëlarja e parave përkufizohet përgjithësisht përfshirje apo angazhim në akte të menduara për të fshehur apo mbuluar prejardhjen e vërtetë të të ardhurave të fituara me veprë penale ashtu që të ardhurat të duken si rrjedhje nga prejardhje legjitime apo të përbëjnë pasuri legjitime. Përgjithësisht, shpëlarja e parave ndodh në tri faza:

- (a) Paratë së pari hyjnë në sistemin financiar në fazën e “plasimit”, në të cilën paratë e krijuara me veprimtari kriminale depozitohet në llogari të institucioneve financiare, apo konvertohen në instrumente monetare.
- (b) Në fazën e “shtresimit”, fondet transferohen apo lëvizën drejt llogarive të tjera apo institucioneve financiare për të larguar edhe më shumë paratë nga prejardhja e tyre kriminale.
- (c) Në fazën e “integritit”, fondet rikthehen në ekonomi dhe përdoren për të blerë pasuri legjitime apo për të financuar aktivitete tjera kriminale ose biznese legjitime.

5. Financimi i terrorizmit mund të mos përfshijë të ardhura nga veprime kriminale, por është më shumë përpjekje për të fshehur ose prejardhjen e fondeve ose përdorimin e tyre të synuar, që mund të jetë për qëllime kriminale. Burimet legjitime të fondeve janë dallimi kryesor ndërmjet financuesve të terrorizmit dhe organizatave kriminale tradicionale. Përveç donacioneve humanitare, burimet legjitime mund të jenë edhe sponsorët e qeverive të huaja, pronësia në biznese dhe punësimi personal. Edhe pse motivi dallon ndërmjet shpëlarësve tradicionalë të parave dhe financuesve të terrorizmit, metodat që përdoren për financimin e operacioneve terroriste mund të jenë të njëjta ose të ngjashme me metodat që përdoren nga kriminelët tjerë për të shpëlarë paratë. Financimi për sulme terroriste jo gjithmonë nënkupton shuma të mëdha të parave, ndërsa transaksionet përkatëse mund të mos jenë aq të ndërlikuara.

2. Përgjegjësitë

1. Bordi i FKGK-së ka përgjegjësi përfundimtare për funksionimin e mirëfilltë të FKGK-së. Në këtë drejtim, Bordi miraton të gjitha politikat e FKGK-së, duke përfshirë politikat me qëllim të parandalimit të përfshirjes së FKGK-së në shpëlarje të parave, financim të terrorizmit apo aktivitete tjera të paligjshme.

2. Drejtori Menaxhues i FKGK-së cakton një Person për Programin e Përputhshmërisë kundër Shpëlarjes së Parave (Personi për Përputhshmëri SHL) nga radhët e

personelit ekzistues në FKGK. Personi për përputhshmëri SHL mund të jetë udhëheqësi i Funkcionit të Përputhshmërisë, person në kuadër të Funkcionit të Përputhshmërisë, apo ndonjë zyrtar tjetër të nivelit të lartë në FKGK. Personi për përputhshmëri SHL do të ketë përgjegjësi të plotë për ekzekutimin e programit SHL të FKGK-së, siç miratohet nga Bordi i FKGK-së. Personi për përputhshmëri SHL duhet të ketë njohuri pune të Ligjit për SHL/LFT si dhe aktet zbatuese të tij, si dhe duhet të jetë i kualifikuar, me përvojë, njohuri e trajnim, për të ushtruar funksionet e caktuara.

3. Personi për përputhshmëri SHL do të jetë përgjegjës për krijimin e një programi përputhshmërie, në pajtim me politikën SHL/LFT të miratuar nga Bordi, për adresimin e praktikave të kujdesit të duhur në bazë të rreziqeve të identifikuara, për mbajtjen e trajnimeve ashtu që të gjithë punëtorët e FKGK-së të jenë në pajtim me ligjet e rregulloret në fuqi dhe standardet ndërkombëtare për SHL të publikuara deri sot, si dhe për definimin e detyrave dhe rregullave që kanë të bëjnë me funksionalitetin e programit. Elementet kyçe të programit janë përshkruar në nenin 3 si më poshtë.

4. Personi për përputhshmëri SHL është i autorizuar për të kërkuar dhe për të pasur qasje në të gjitha informatat dhe dokumentet përkatëse nga të gjitha departamentet brenda FKGK-së, që ndërlidhen me fushëveprimin e tij/saj, për të marrë vendimet në mënyrë të pavarur.

5. Menaxhmenti i FKGK-së është përgjegjës për implementimin efektiv të të gjitha politikave dhe procedurave për SHL/LFT në baza ditore.

3. Programi i përputhshmërisë/Menaxhimi i rrezikut

1. Programi i përputhshmërisë SHL/LFT i FKGK-së, i përmendur në nenin 2 si më lart, duhet të përmbajë masa konsistente e efektive për të mbrojtur FKGK-në ndaj rreziqeve të përfshirjes në shpëlarje të parave, financim të terrorizmit dhe aktivitete tjera kriminale, si dhe për të siguruar që operacionet e FKGK-së të ushtrohen në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi, si dhe në pajtim me politikat dhe procedurat e brendshme të FKGK-së. Programi i përputhshmërisë përfshin:

- (a) Identifikimin e rreziqeve të SHL/LFT si dhe krijimin e masave të nevojshme të monitorimit dhe kontrollit në vlerësim dhe zbutje të atyre rreziqeve;

- (b) Mbikëqyrjen e komunikimeve dhe ofrimin e trajnimeve për punëtorët e FKGK-së;
- (c) Sigurimin e mbajtjes dhe mirëmbajtjes së dosjeve e regjistrave të FKGK-së;
- (d) Bashkëpunimin me NJIQ-në sipas nevojës;

2. Për të pasur program efektiv të përputhshmërisë për SHL/LFT në FKGK, FKGK-ja duhet të sigurojë që institucionet e regjistruara financiare të kenë kryer kontrollet e duhura të konsumatorëve, ashtu që të sigurojnë verifikimin e plotë të identitetit të konsumatorëve të tyre; të sigurojë informata të domosdoshme dhe të sakta për biznesin e konsumatorit, para se të hyjnë në marrëdhënie afariste; si dhe që të bëhen hapat e nevojshëm për të siguruar identifikimin e mirëfilltë të konsumatorëve kur ka dyshime në lidhje me vërtetësinë apo përshtatshmërinë e të dhënave identifikuese të siguruara më herët, apo kur ka dyshime që konsumatori mund të jetë përfshirë në shpëlarje të parave apo financim të terrorizmit. Masat e përmendura në nën-paragrafin (a) të paragrafit 1 si më lart pra përfshijnë më së paku pikat vijuese:

(a) Konfirmimin me shkrim nga zyrtari përgjegjës i secilit IF, që IF-ja:

- (i) Për njohuritë e tij aktuale, në dhjetë vitet e fundit, nuk ka ofruar përkrahje materiale apo resurse për asnjë individ apo subjekt që ka kryer apo kryen apo ka tentuar të kryejë, avokojë, lehtësojë apo të marrë pjesë në shpëlarje të parave apo akte terroriste, apo ka kryer, ka provuar të kryejë, ka lehtësuar, ka marrë pjesë në akte të tilla;
- (ii) Nuk do t'i ofronte, me njohuritë e veta, përkrahje materiale apo resurse asnjë individi apo subjekti të tillë;
- (iii) Ka ndërmarrë, si dhe do të ndërmarrë, të gjitha veprimet brenda mundësive të veta për të siguruar që asnjë prej kredive që kërkon t'i vërë nën mbulimin e garancive të FKGK-së të mos i jepen një individi apo subjekti të tillë, duke marrë parasysh të gjitha informatat për kredimarrësin e ardhshëm për të cilat ka dijeni, si dhe informatat publike që janë arsyeshmërisht në dispozicion, apo për të cilën do të duhej të kishte njohuri;

- (iv) Do të njoftojë menjëherë FKGK-në nëse ai IF zbulon që ndonjë kredi e garantuar nga FKGK-ja nuk plotëson më kriteret e nën-pikës (iii).

3. FKGK nuk regjistron asnjë institucion financiar, e as nuk garanton asnjë kredi që nuk plotëson kriteret e lartpërmendura.

4. Monitorimi dhe kontrolli

1. Qëllimi i monitorimit dhe kontrollit është të mbrojë FKGK-në ndaj rreziqeve, si dhe të monitorohet e kontrollohet në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar që operacionet e FKGK-së të kryhen në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, si dhe me politikat dhe procedurat e FKGK-së.

2. Në kuadër të aktiviteteve të monitorimit e kontrollit, mangësitë e zbuluara si pasojë e kontrolleve të kryera për të siguruar zbatimin e obligimeve i raportohen njësisive përkatëse për të marrë masat e duhura, si dhe sigurohen reagimet e duhura. Aktivitetet që janë pjesë e fushëveprimit të monitorimit ekzekutohen nën drejtimin e personit përgjegjës për SHL, i cili mund të ketë qasje në departamentet tjera të FKGK-së kurdo që ka nevojë.

5. Ndërlidhja me Politikën Investuese të FKGK-së

1. Para se fondet e FKGK-së të investohen në ndonjë institucion financiar, FKGK-ja do të bëjë hulumtimet e duhura për të mësuar nëse:

- (a) Nëse institucioni financiar ka në zbatim një program efektiv e gjithëpërfshirës për përputhshmëri në SHL/LFT; si dhe
- (b) Nëse institucioni financiar gjendet në një vend të huaj, nëse ai vend ka zbatuar regjimin SHL/LFT në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë veçanërisht rekomandimet e Task-Forcës Vepruese Financiare (FATF), si dhe nëse është anëtar i FATF-së.

2. FKGK nuk investon fondet e veta në institucionet financiare që nuk plotësojnë kriteret e paragrafit 1 të këtij neni.

6. Mbajtja dhe ruajtja e dosjeve

1. FKGK do të mbajë të gjitha regjistrimet e nevojshme të transaksioneve, si dhe dosjet në lidhje me garancitë, pronarët, apo të autorizuarit, dosjet e llogarive dhe korrespondencën afariste për së paku pesë vjet pas përfundimit të marrëdhënies afariste apo kryerjes së transaksionit (ose edhe më gjatë nëse kërkohet nga BQK-ja, NJIF-ja, apo ndonjë autoritet tjetër kompetent në raste specifike). Kjo kërkesë vlen pa marrë parasysh nëse marrëdhënia afariste është aktuale apo është ndërprerë. FKGK-ja do t'i vërë në dispozicion BQK-së, NJIF-së apo autoriteteve tjera kompetente të gjitha dosjet dhe informatat në dispozicion në bazë të kërkesës.

2. Kurdo që FKGK-ja të marrë në dijeni që dosjet e caktuara janë pjesë e hetimeve në vazhdim, dosjet e tilla do të ruhen e mbahen deri në konfirmimin e asaj agjencie ligjzbatuese që ai rast është mbyllur.

7. Trajnimi

FKGK-ja do të sigurojë trajnime adekuate dhe të freskuara në lidhje me SHL/LFT për të gjithë personelin e tij. Trajnimet mbahen për të siguruar përputhshmërinë me ligjet dhe rregulloret në fuqi, si dhe për të ngritur vetëdijen e personelit në lidhje me rreziqet e pranishme dhe përgjegjësitë e tyre në mbrojtje të FKGK-së. Aktivitetet e trajnimit në lidhje me parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit do të mbahen në pajtim me vëllimin e punëve, fushëveprimin dhe rrethanat e FKGK-së. Trajnimet do të mbahen nën mbikëqyrjen dhe bashkërendimin e personit të caktuar si përgjegjës për përputhshmëri në lidhje me SHL.

8. Zbatimi i kësaj Politike

Kjo Politikë është vendosur për të siguruar funksionimin e rregullt të FKGK-së, si dhe për të vendosur rregullat e brendshme të sjelljes si dhe standardet profesionale që kërkohen nga të gjithë punëtorët dhe menaxherët e FKGK-së. Në çdo rast kur ka konflikt ndërmjet Politikës dhe ligjit në fuqi, ligji në fuqi do të mbizotërojë.

9. Ndryshimet/plotësimet

Kjo Politikë do të rishikohet nga Bordi i Drejtorëve të FKGK-së së paku një herë në vit, si dhe mund të ndryshohet kohë pas kohe siç e sheh të nevojshme Bordi, në përgjigje ndaj ndryshimit të rrethanave apo për të siguruar zbatimin e ligjeve në fuqi.

10. Sanksionet

Çdo shkelje e dispozitave relevante të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës përballet me sanksione në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 03/L-196 për Parandalimin e Shpëlarjes së parave dhe Financimit të terrorizmit, ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-178 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-196 për Parandalimin e Shpëlarjes së parave Financimit të terrorizmit.